



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	31-05-2021	viti god year	1
Organ./Njesta Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKENDERAJT	2747/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.339/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2942/2019 të datës 28.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.450/2019 të datës 08.08.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë Rr. Fidanishte, Nr.8, Komuna e Skenderajt, kundër Vendimit me numër Nr.02-112-01-0038450/19 të datës 23.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.450/2019 e datës 08.08.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli Nr.02-112-01-0038450/19 i datës 23.07.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt.

A r s y e t i m

Komuna e Skenderajt në bazë të Autorizimit të datës 19.04.2019 të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike, me datë 24.04.2019 ka shpallur konkursin publik me numër 111/01-002383/19 për pozitën "Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave", në Drejtorinë për Administratë, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. E njëjta nga Komisioni Përzgjedhës i Themeluar me Vendimin 02 Nr.020/04-0028426/19 të datës 16.05.2019, nuk është përfshirë në listën e shkurtër me arsyetimin që nuk ka plotësuar kushtet e konkursit respektivisht atë të kualifikimit arsimor.

Ankuesja kundër njoftimit me numër 02-112/01-0033049/19 të datës 07.06.2019 të Komunës së Skenderajt, për shpalljen e kandidatit të suksesshëm, më datë 25.06.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt. Ky i fundit me

Vendimin me numër protokoli Nr.02-112-01-0038450/19 të datës 23.07.2019, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses dhe ka lenë në fuqi Njoftimin e kandidatit të suksesshëm të datës 07.06.2019, me arsyetimin se procedura e rekrutimit për pozitën në fjalë është zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër protokoli Nr.02-112-01-0038450/19 të datës 23.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Skenderajt, nëpërmjet postës më datë 06.08.2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 08.08.2019, me numër protokoli 3471/2019 të regjistruar me A. Nr.450/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.08.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Skenderajt. Ndërsa me datë 26.08.2019, Këshilli ka pranuar nga Komuna e Skenderajt dokumentacionin lidhur me procedurën e kontestuar të rekrutimit si dhe provat shtesë sipas emalit të datës 25.05.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 28.04.2021 ka nxjerr Aktgjykimin Anr.2492/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 08.08.2019 të parashtruar nga ankueses

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër të lëndës 2019:287060 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Ankeswn e ankuesit e datës 08.08.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 02-112-01-0038450/19 tw datës 23.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Skenderajt; Njoftimin lidhur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i datës 25.07.2019 nga Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Skenderajt; Konkursin me numër 111/01-0023838/19 i datës 24.04.2019; Autorizimin e datës 19.04.2019 tw Ministrisë së Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil; Vendimin me 01Nr. 020/04-0028426/19 i datës 16.05.2019 për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Regjistrin e Aplikacioneve të Pranuara Form.MAP-SHCK-04; Akt Emërimin me numër 112-900 i datës 01.11.2012; Akt Emërimin me numër 112-422 i datës 07.05.2012; Akt Emërimin me numër 112-283 i datës 25.04.2012; Akt Emërimin me numër 112/01-0020338/8 i datës 04.04.2018; Listën e kandidatëve e datës 21.05.2019; Vlerësimin individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a; Testin me shkrim i datës 24.05.2019; Raportin final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues Form.MAP-SHCK-11; Regjistrin e Aplikacioneve të Pranuara Form.MAP-SHCK-04; Kërkesën për punësim Form.MAP-SHCK-03 e me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim Form.MAP-SHCK-03 e me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim Form.MAP-SHCK-03 e me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim Form.MAP-SHCK-03 e me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim Form.MAP-SHCK-03 e me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim Form.MAP-SHCK-03 e me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim Form.MAP-SHCK-03 e me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim

Form.MAP-SHCK-03 e me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim
Form.MAP-SHCK-03 e me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim
Form.MAP-SHCK-03 e me dokumentacionin e bashkangjitur; Njoftimi i datës
07.06.2019; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues Form.MAP-SHCK-11 i datës
07.06.2019 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar pretendime ankimore të ankueses si dhe shkresat e lëndës, ka konstatuar që ankesa e ankueses **është e pa bazuar, sepse:**

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesja pretendon se lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave" në Drejtorinë për Administratë, pranë Komunës së Skenderajt, janë bërë shkelje procedurale dhe materiale, duke theksuar me tej se pa të drejtë nuk është përfshirë në listë të shkurtër me arsyetimin së e njëjta ka plotësuar kushtet dhe kriteret par pozitën në fjale, në testin me shkrim kanë hyrë vetëm dy persona, dhe së përbërja e Komisionit Përzgjedhës ka qenë në kundërshtim me ligjin.

Dukë ju referuar Konkursit Publik me numër 111/01-002383/19 të datës 24.04.2019, kritere themelore për pozitën "Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave", në Drejtorinë për Administratë/Komuna e Skenderajt kanë qenë: *Diplomë Universitare-Fakulteti Juridik dhe Fakulteti i FSHMN-së, së paku 2 vite provojë pune.*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur së në këtë konkurs, kanë aplikuar gjithsej dhjetë (10) kandidatë. Në listë të shkurtër janë përfshirë vetëm tre kandidatë gjegjësisht në këtë listë nuk është përfshire ankuesja për shkak se e njëjta nuk ka plotësuar kriterin e arsimimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se pa të drejtë nuk është përfshirë në listë të shkurtër nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës respektivisht Diplomën me Nr. 38/65 të datës 21.12.1994 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, ka konstatuar se ankuesja ka të përfunduar Fakultetin e Inxhinierisë dhe Metalurgjisë, andaj mbi këtë konstatim Kolegji vlerëson se ankuesja nuk posedon fushën e arsimimit përkatës, rrjedhimisht Komisioni Përzgjedhës me rastin e mos përfshirjes së ankueses në listën e shkurtër ka vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Anëtar e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: arsimimi dhe kualifikimi profesional..."*, dhe nenin 24 paragrafit 1 të njëjtës Rregullore i cili përcakton se: *"Përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve të dorëzuara nga kandidatët e interesuar për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit në Shërbimin Civil"*.

Përkitazi me pretendimin ankimor së testimi me shkrim është mbajtur vetëm me dy kandidatë, Kolegji duke ju referuar shkresave të lëndës si dhe dispozitave të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenit 29 paragrafi 1 i cili përcakton se: *KSHC duhet të përgatisë një listë të shkurtër prej se paku tre kandidatëve për përfshirje në listën e shkurtër,...* ka konstatuar së në listën e ngushtë të datës 21.05.2019 janë përfshirë gjithsej 3 kandidatë dhe atë E. F. dhe G. ndërsa procedurës se mëtejme të vlerësimit i janë nënshtruar vetëm dy kandidatë dhe atë dhe F. e në këtë kuptim pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor se përbërja e Komisionit Përzgjedhës ka qenë në kundërshtim me ligjin, Kolegji pas vlerësimit të provave të lëndës ka konstatuar së përbërja e Komisionit



Përzgjedhës sipas Vendimit me numër 02Nr.020/04-0028426/19 të datës 16.05.2019, ka qenë në pajtim me nenin 7 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil respektivisht është respektuar hierarkia e pozitës si dhe parimi i përfaqësimit gjinor, e mbi këtë konstatim pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë vlerësimit të provave të lëndës ka konstatuar se kandidati i zgjedhur G. ka plotësuar kriteret referuar konkursit publik për pozitën "Zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave", respektivisht sipas Diplomës me numër 150 të datës 26.03.2012, ka përfunduar me datë 30.09.2011 Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, në drejtimin e Agroekonomisë, ndërsa lidhur me përvojën e punës pas diplomimit posedon Certifikatën e Punësimit të datës 03.02.2015 të lëshuar nga Departamenti për Burime Njerëzore të FINCA ku i njëjti ka punuar për periudhën mars-nëntor 2014 si analist i kredive bujqësore, sipas Rekomandimit të datës 03.01.2014 ka punuar për periudhën tetor-dhjetor 2013 në IAD-së si Hulumtues për grumbullimin e informatave për kontabilitetin e bujqve, ndërsa duke u bazuar në Pasqyrën e Trust-it për periudhën 01.08.2002 deri 02.05.2019 i njëjti është i punësuar në Agjencionin për Financim të Kosovës nga marsi 2017 e tutje.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve edhe Ankesave i Komunës së Skenderajt, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.02-112-01-0038450/19 të datës 23.07.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen kontestuese.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e anëshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.339/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- Menaxherit të Personelit të Komunës së Skenderajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.